



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLIGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërive GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C. nga shoqëritë Statkraft Peru S.A. dhe Statkraft Peru Holding S.A.C.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar shkresa nr. 694/6 datë 28.12.2022 “Njoftim përqendrimi në kuadër të njoftimit të përfimit të kontrollit të Statkraft Peru S.A. dhe Statkraft Peru Holding S.A.C. mbi GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C.”, ku jemi njoftuar lidhur me nënshkrimin e marrëveshjeve së blerjes së aksioneve të shoqërive GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C. nga shoqëritë Statkraft Peru S.A. dhe Statkraft Peru Holding S.A.C.

Referuar “Marrëveshjeve për Blerje të Aksioneve”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Blerësi 1: Statkraft Peru S.A. është një shoqëri anonime, me objekt aktiviteti: Prodhimi, transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike në nivel kombëtar dhe në përgjithësi, përkushtimi të të gjitha aktivitetet dhe bizneset që lidhen me aktivitetet e përmendura më sipër, qoftë për llogari të vet ose të palëve të treta.

Blerësi 2: Statkraft Peru Holdings S.A.C. është një shoqëri anonime e mbyllur, me objekt aktiviteti: Angazhimi për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit, administrimit, mbështetjes, konsulencës e këshillimit dhe çdo veprimtarie tjetër të korporatës, në përgjegjësinë financiare, tregtare, sociale, ligjore, në sektorin e energjisë elektrike, për zhvillimin e projekteve të prodhimit të energjisë elektrike, investimeve dhe gjithë aktiviteve të tjera të lidhura me to.

Blerësit janë pjesë e grupit Statkraft, lider në sektorin e energjisë dhe aktori më i madh i prodhimit të hidroenergjisë së rinovueshme në Evropë.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve Devoll Hydropower SHA dhe Statkraft Renewables Albania SHPK, të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Shoqëritë Target:

1. GR Vale S.A.C. është një shoqëri anonime, e themeluar sipas ligjeve të Perusë, me objekt aktiviteti: Veprimtari në fushën e energjisë, energjisë së rinovueshme, ruajtja e energjisë elektrike dhe hidrocentralet me pompa.
2. GR Bayovar S.A.C. është një shoqëri anonime, e specializuar në gjenerim, transmetim dhe shpërndarje të energjisë elektrike.

Shoqëritë Target nuk janë prezent dhe nuk gjenerojnë xhiro në Shqipëri.

Pala shitëse:

Shitësi 1: Grenergy Peru S.A.C. është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Perusë.

Shitësi 2: Grenergy Renovables S.A. është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Spanjës.

Shitësit janë aksionarët e vetëm të shoqërive GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.